



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



AMERICAN BAR ASSOCIATION

Rule of Law Initiative

RIKTHIMI I LOJRAVE TË FATIT PËRBALLË RISQEVE TË PASTRIMIT TË PARAVE

PËRGATITUR NGA **OLA XAMA**, GAZETARE

NËNTOR 2022

HYRJE

“Lojrat e fatit bashkë me tregun e pasurive të patundshme shihen si dy sektorët me rrezikun më të lartë për pastrimin e parave.” do të konstatonte në verën e vitit 2018 Këshilli i Europës në një raport për Shqipërinë. Raporti i parapriu vendimit të qeverisë për të mbyllur tërësisht tregun e bixhozit në vend, i cili ishte kthyer në një rrezik dhe luftë të madhe mes aktorëve të saj, ku një pjesë e mirë e segmentit të tij ishte kapur nga grupe të njohura kriminale.

“Autoritetet shqiptare besojnë se lojrat e fatit dhe pasuritë e patundshme janë sektorët më të ndjeshëm sa i takon pastrimit të parave. Për lojrat e fatit rreziku kryesor lidhet me pronësinë dhe kontrollin e disa aktiviteteve nga individë me risk të lartë sesa me vetë aktivitetin që bëjnë klientët.” do të argumentonte më tej raporti i KE-së.

Disa muaj më pas rreziku që sektori përbënte për ekonominë e vendit dhe shtrirja e tij në duart e disa grupeve kriminale do të detyronte kryeministrin që të merrte një vendim drastik me mbylljen e të gjithë tregut të lojrave të fatit. Deri në fund të vitit 2018 tregu i lojrave të fatit kapte një vlerë prej 130 milion euro e ndarë në 82.6 milion euro për kazinotë dhe 49.6 milion euro për bastet, pjesa tjetër i takonte Lotarisë Kombëtare dhe Bingove.

Numri i pikave të basteve ishte rritur në mënyrë eksponenciale gjatë dekadës së fundit duke kapur një rekord prej 4200 pikash, të cilat operonin përmes 3 kompanive të licensuara në këtë treg: ITSGA, Lotto Sport dhe Top Start. Interesi i grupeve kriminale për të hyrë në fushën e lojrave të fatit solli dhe zbatimin e një skeme të re, ku shumica e pikave operonte përmes NIPT-eve sekondare kundrejt një qiraje që i jepej kompanisë që kishte licensën. Ligji i ri “Për Lojrat e Fatit” i miratuar në vitin 2015 kufizonte ndjeshëm numrin e pikave të bastit që do të operonin në Shqipëri duke vendosur distancën në 200 metra vijë ajrore largësi nga njëra-tjetra dhe larg objekteve arsimore dhe atyre të kultit. Investimi në këtë fushë nga persona me aktivitet kriminal dhe lobimi i bizneseve të sektorit shtyu dy herë afatin e hyrjes në fuqi të ligjit të ri, duke e lënë për në vitin 2019. Tashmë në këtë pikë i takonte qeverisë për të marrë një vendim.

“Ligji i ri lejonte hapësirë për operimin e jo më shumë se 1500 pikave të bastit në të gjithë vendin, kjo do të thoshte mbylljen e automatikisht 2500 pikave ku një pjesë e mirë e zinxhirit të tyre ishin në pronësi të grupeve të ndryshme kriminale. Kush do të rrinte dhe kush do të dilte nga tregu, ndërkohë që investimet në hapjen e pikave ndër vite ishin të mëdha? E gjithë kjo çështje mund të kthehej në një luftë të re për grupet kriminale, çka besoj se ka çuar dhe qeverinë drejt këtij vendimi drastik.” thotë për IDM Albania një ish-zyrtar i lartë i Policisë së Shtetit në ato vite në kushtet e anonimatit.

Lufta me lojrat e fatit dhe bizneset që kishin zënë këtë treg ka qënë e vazhdueshme në vite nga autoritetet. Edhe pse qeveria e majtë e sapoardhur në pushtet në vitin 2013 nisi një aksion për formalizimin e këtij tregu të quajtur “Fundi i Marrëzisë”, kontrolli i parave që qarkullonte në këtë sektor ishte deri diku i pamundur duke detyruar mbylljen e tyre.

“Shumë nga pronarët e basteve janë me precedentë penale. Edhe pas operacionit ‘Fundi i marrëzisë’ marrëzia nuk është mbyllur. 5 mijë pika operojnë në vend dhe qindra miliona lëvizin jashtë kanaleve të ligjit. Ajo që ne bëjmë sot është kundërpërgjigja e duhur ne emër të një shoqërie të prekur nga ky fenomen.” do të thoshte në tetor të 2018-s kryeministri Edi Rama gjatë seancës ku do të miratohej mbyllja e të gjithë sektorit të lojrave të fatit, duke përmendur dhe kërcënimin që u ishte bërë disa deputetëve për të votuar kundër vendimit. *“Respekt për të gjithë ata që kaluan një periudhë stresi të vecantë me shumë “sms”*

të llojeve të ndryshme dhe atyre që i kanë cuar ato "sms" që i kanë porositur nga jashtë apo brenda burgut." tha kryeministri.

"Mbyllja e lojrave të fatit me përdorimin e argumenteve sociale nuk qëndron. Mendoj se ka qënë një mënyrë për të mbyllur hesapet, për të shmangur dimensionin e vërtetë që kishte marrë fenomeni dhe për të përgatitur terrenin e përqëndrimit në pak duar të sektorit të ri-rregulluar dhe për të orientuar fluksin e parave drejt operatotrëve që kanë mbetur në treg." thotë drejtori i Qendrës për Kërkime Ekonomike Zef Preçi.

Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë mbylli tërësisht sektorin e lojrave të fatit dhe lejoi operimin dhe për 1 vit e gjysëm të "Regency Casino" e cila kishte paguar para 13 vjetësh për marrjen e një licence kombëtare. Zotimi ishte që të mos kishte më licenca në këtë fushë dhe kazinotë të hapeshin në zona turistike nga operatorë me emër.

RIKTHIMI I BASTEVE – QEVERIA NË PËRGATITJE TË LIGJIT TË RI

Një letër – peticion e Komitetit Olimpik Shqiptar e firmosur nga 59 drejtues dhe anëtarë federatash sportive iu drejtua Kryeministrit Edi Rama në verën e këtij viti. Letra u publikua në periudhën kur Luiza Gega u shpall Kampione e Europës në disiplinën e atletikës, event i cili i rikujtoi publikut fondet e ulta në fushën e sportit dhe kushtet e vështira të stërvitjes së saj. Letra e iniciuar nga ish-deputeti socialist Fidel Ylli i kërkonte qeverisë rihapjen e pikave të bastit dhe rritjen e fondeve për sportin. Argumenti mbështetej në dy pika kryesore: lulëzimin e basteve në mënyrë të jashtëligjshme dhe mungesën në buxhet të taksave që mund të vinin nga legalizimi i tyre.

“Vendimi për mbylljen e lojrave të fatit ka qënë i drejtë për kohën, sepse kanë qënë të përhapura vend e pa vend. Por bastet sportive vazhdojnë të jenë në informalitet dhe kjo ka bërë që të ardhurat nga kjo veprimtari t’i shkojnë krimin. Në të njëjtën kohë që përfitime financiare që mund t’i shërbejnë rinisë i shkojnë krimin, Federatave Sportive në Shqipëri këtë vit u është akorduar një fond jashtëzakonisht i vogël, i cili mund të sjellë edhe falimentimin e Federatave.” shkruhej në letër.

Përgjigjja për këtë kërkesë erdhi nga vetë kryeministri Rama, i cili tha se tashmë kishte ardhur koha që aktiviteti të rihapej dhe t’i jepej fund operimit të basteve në mënyrë të jashtëligjshme nga eksponentë me profile të larta kriminale. *“Kjo kornizë që e ka përfshirë Policinë e Shtetit në përpjekje për t’i parandaluar dhe për t’i çuar para ligjit organizatorët e basteve online në të zezë. Ku për hir të vërtetës ka pasur dhe një pjesëmarrje aktive të disa elementëve të skeduar si profile të larta kriminale dhe drejtori i Agjencisë së Lojrave të Fatit mbulon pjesën që është ligjrisht e qartë dhe nuk ka kompetencë të ndjekë aktivitetin ilegal që është kompetencë e Policisë së Shtetit”* tha kryeministri.

Pohimi i tij për lejimin e basteve ka bërë që ministria e Financave dhe Ekonomisë të nisë punën për përgatitjen e projektligjit i cili pritet të miratohet gjatë këtij sesioni parlamentar dhe të hyjë në fuqi në janar të vitit të ardhshëm. Ministria e Financave parashikon që të ardhurat në buxhet nga legalizimi i basteve të jenë 17 milion euro, çka pritet që tregu i lojrave të fatit vetëm për kategorinë e basteve të zërë një volum prej 80 milion euro.

Ekspertët shohin disa risqe në fushën e pastrimit të parave nga rikthimin e këtij aktiviteti: *“Përbën rrezik për faktin se në këtë sektor operohet me një numër të madh individësh që shkojnë dhe luajnë, çka e bën më të favorshëm fshehjen e burimit dhe janë kryesisht në shumën nën limitin ligjor për të gjurmuar burimin e parave, janë më pak se 10 mijë dollarë dhe vështirësohet kontrolli dhe inspektimi. Kështu krijohen premisa që sektori të përqëndrohet në pak duar, formale, informale dhe një pjesë kriminale.”* sqaron Zef Preçi.

BOOM-I I KAZINOVE

Zona përreth stadiumit "Air Albania" është kthyer në një nga vendet më tërheqëse të kryeqytetit që prej përfundimit të tij nga kompania Alb-Star. Edhe pse stadiumi u inagurua që në nëntor të vitit 2019, punimet për përfundimin e qendrës tregtare rreth tij dhe një kulle e cila do të ofrojë shërbime hoteliere vazhdojnë. Kompania Alb-Star ka pronësinë e kullës dhe dyqaneve përreth stadiumit falë një kontrate pratneritet publik-privat të firmosur me Federatën Shqiptare të Futbollit ku në këmbim të ndërtimit të stadiumit do të merrte pronësinë e kullës dhe dyqaneve.

Në sheshin "Italia" përpara stadiumit bashkohen të gjithë brezat: të rinjtë që shfrytëzojnë lokalet dhe jetën e natës, fëmijë që luajnë dhe të moshuar që shëtitin. Përgjatë kësaj zone gjenden bare, restorante, dyqane veshjesh dhe së fundi këtyre bizneseve i është shtuar edhe një kazino me emrin "Arena".

"Arena" nuk është kazinoja e vetme në zonën përreth stadiumit. Përballë saj u hap gjatë fundit të vitit të shkuar "Royal Eagle Casino", ndërsa në vitin 2020 Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit licensoi "Grand Casino Tirana" në afërsi të qendrës së kryeqytetit dhe rinovoi licencën kombëtare për "Regency Casino" e cila ushtronte aktivitetin prej 15 vjetësh pranë kompleksit "Taivan" në zonën e Shallvareve.

Një tjetër licencë është miratuar gjatë vitit të shkuar për "Marina Bay Casino" me vendodhje në zonën e Ujit të Ftohtë në Vlorë. Ekspertët shtrojnë pikëpyetje për interesin që kanë bizneset në hapjen e aktiviteteve në fushën e lojrave të fatit, ndërsa numërojnë si një nga risqet kryesore të këtij sektori pastrimit e parave të pista.

"Nuk ka asnjë sponstim në periferi, kazinotë do të jenë të mundura vetëm për hotelet apo resortet me 5 yje në zonat e definuara me vendim të qeverisë dhe të gjithë autoriteteve përkatëse të planifikimit të territorit si "zona turistike". Ta përshpejtojmë procedurën, që sa më shpejt të mbyllet ky film dhe sa më shpejt në shtëpitë e shqiptarëve të shkojë mesazhi që ky film u mbyll!" tha gjatë fjalimit për mbylljen e bixhozit kryeministri në vitin 2018.

Por pavarësisht këtyre deklaratave dhe mbylljes së mijëra bizneseve në Shqipëri tregu i lojrave të fatit po i ringrihet mes pikëpyetje mbi pronësinë e grupeve që e zotërojnë atë dhe riskut të pastrimit të parave. Që nga viti 2020 dhe deri më sot numri i kazinove në të gjithë vendin ka arritur në pesë, ku katër prej tyre janë të vendosura në kryeqytet.

Të dhënat zyrtare tregojnë se gjatë vitit të shkuar kaziontë deklaruan një xhiro vjetore 52 milion euro, shifër e ngjashme me nivelet kur në Shqipëri lejohej aktiviteti i kazinove me salla dhe atyre elektronike dhe e konsiderueshme nëse vendoset në kontesktin e pandemisë ku qarkullimi dhe lëvizja e qytetarëve ishte e kufizuar.

Në vitin 2020 tregu i kazinove ishte 23.7 milion euro, ndërsa operuan vetëm dy prej tyre "Regency Casino" dhe "Grand Casino Tirana" e vendosur pranë Hotel Piazza.

Të dhënat e bilanceve zyrtare të dorëzuara pranë tatimeve tregojnë se gjatë vitit 2021 tregu është dyfishuar. Dominimin më të madh në biznesin e lojrave të fatit e ka "Adria Entertainment" e vendosur pranë Hotel Plaza me 29 milion euro xhiro dhe një fitim neto në vlerën e 3.3 milion eurove.

Vitin e shkuar pranë "Regency Casino" janë luajtur 19 milion euro dhe fitimi i realizuar është 3.5 milion euro. Të dhënat e tregut tregojnë se dy kazinotë e tjera të hapura përgjatë vitit 2021 kishin një xhiro vjetore më të ulët. 3.4 milion euro në "Royal Eagle" dhe 500 mijë euro pranë "Marina Bay" në Vlorë. Këto dy kazino rezultuan me një humbje vjetore përkatësisht prej 2 milion euro dhe 127 mijë euro për kazinone e Vlorës.

KUSH E DOMINON SOT TREGUN? STRUKTURA E AKSIONERËVE

Ridhënia në tetor të vitit 2020 e licencës për kazino tregtare nxorri në pah se pavarësisht një ligji të rreptë për filtrimin e pronarëve në këto aktivitete dhe kufizimit me ligj të personave të dënuar për vepra penale, lobet me të shkuar të dyshimtë gjetën rrugën për të qëndruar në këtë treg. Një nga pronarët përfitues të “Regency Casino” në kohën e licensimit ishte dhe Albano Aliko, i dënuar nga gjykata për veprën e mashtrimit financiar, e njohur si skema e mashtrimit me tollonat e naftës “Gulf”, e cila u shiti kupona naftë dhjetra qytetarëve, kompanive ku mes tyre ishin edhe institucione shtetërore.

Po ashtu dhënia e licencës për kazinonë në Vlorë ka ndezur debatin publik se çfarë filtrash janë përdorur për depërtimin e kompanive me origjinë nga Meksika në Shqipëri. Meksika shihet si një vend me rrezik të lartë sa i takon pastrimit të parave në fushën e lojrave të fatit, çka për ekspertët duhet t'i bëjë më shumë vigjilentë autoritetet.

“Rreziku për depërtimin e parave me origjinë nga krimi është gjithmonë evident dhe varet nga kapaciteti dhe integriteti i agjencive ligjzbatuese. Dominimi nga një numër i kufizuar operatorësh krijon mundësi për të orientuar fluksin e parave. Është një garë mes sektorit formal dhe atij informal për të bashkë kontrolluar këtë sektor.” thotë Preçi.

Dokumentat e dorëzuara pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit tregojnë se dy aktorë të vjetër të tregut ish - pronari i kompanisë “Apex-Al”, Bledar Sinani dhe Johannes Weissengruber dominojnë 53% të tregut të lojrave të fatit në Shqipëri duke u renditur të parët. Tre licenca të dhëna për operim në kryeqytet zotërohet nga dyshja Sinani - Weissengruber, edhe pse nuk janë pronarë në fushën e hotelerisë, kriter ligjor për dhënien e licencave të kazinove në hotele me 5 yje. 37% e tregut zotërorhet nga “Regency Casino”, ndërsa për vitin 2021 “Marina Bay” arriti të kapë vetëm 1% të tregut.

RREZIKU I PASTRIMIT TË PARAVE

Industria e lojrave të fatit është një nga më të përdorurat për pastrimin e parave nga grupime që kanë siguruar fitime të jashtëligjshme. Skema që përdoret në këtë treg është realizimi i një fitimi nga një lojë në kazino apo biletë basti ku shuma që ka luajtur individi është shumë e ulët. Nga ana tjetër, i interesuari paguan nën dorë një kosto për shërbimin. Kostoja e larjes së parave në lojrat e fatit është më e lira, pasi nuk ka barrë tatimi mbi fitimin për lojtarin, ndërsa kazinoja ose llotoja që do t'i paguajë atij fitimin do të ketë shpenzime për pagesën e lojtarit që fitoi fiktivisht.

Shpenzimet e pakta në taksa i bëjnë lojrat e fatit më të pëlqyerat për grupet kriminale thonë ekspertët. *“Duke qënë një sektor që mundësitë e kontrollit shtetëror janë të kufizuara, duke qënë një sektor ku gjurmimi është i vështirë dhe me shumë pak hapa operacional: thjesht pjesëmarrje dhe një pagesë formale takse bëhet i dëshiruar për aktivitetin e pastrimit të parave. Ka evidenca që institucione të caktuara derdhen taksa në buxhet por në fakt nuk kanë aktivitet por thjesht shërbejnë si licenca për të pastruar paratë.”* thekson Zef Preçi.

“Fakt është që pas mbyljes ky aktivitet dëshmoi që ishin shuma të mëdha parash informale dhe në vend që të transferoheshin në ekonominë tonë, u transferuan në vendet fqinjë dhe mbetën në disa duar oligopoli të kontrolluar ku ka dyshime edhe për përfshirjen e zyrtarëve të lartë.” përfundon ai.



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo- qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efektive përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Shënim: Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e American Bar Association - Rule of Law Initiative (ABA ROLI).